V E N D I M
Nr.317, datë 8.7.1999

PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE
(Ndryshuar me VKM nr. 261, datë 25.5.2000; nr. 36, datë 20.1.2001)
(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Paga e çdo punëmarrësi llogaritet në bazë të vëllimit të punës, të matur në sasi dhe cilësi, të kohës së punës dhe të klasifikimit e të renditjes së punës.

2. Me "ndërmarrje shtetërore" kuptohet ndërmarrja me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionon sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", ndërmarrja që funksionon sipas ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", si dhe institucioni shtetëror, banka, INSIG-u, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shëndetësore.

3. Ndërmarrjet i caktojnë pagat e punës vetë, në varësi të mundësisë financiare që kanë, sipas programit të zhvillimit, të miratuar nga organet përkatëse.

Në fillim të çdo viti ndërmarrjet bëjnë indeksimin e pagave deri në masën dhe në afatin e përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare, pasi të sigurojnë rezervat, që përcaktohen në dispozitat ligjore, dhe të mos rezultojnë me humbje.

4. Pagat e drejtorëve të ndërmarrjeve, anëtarëve të këshillave drejtuese, anëtarëve të këshillave mbikëqyrëse, sipas tipit të ndërmarrjeve, caktohen apo ndryshojnë nga organi që ka në kompetencë emërimin e tyre.

Raporti i pagës së drejtorit, në krahasim me pagën më të ulët të punonjësve të ndërmarrjes, të jetë sipas këtyre shkallëzimeve :

- për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 1:7 *por jo më shumë se paga e klasifikimit A8*;

- për ndërmarrjet e mëdha dhe strategjike jo më e lartë se paga e klasifikimit A7, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

5. Anëtarët e këshillave drejtuese dhe të drejtorive të ndërmarrjeve kanë të drejtë të marrin shpërblim suplementar deri në 5 për qind të shtesës së fitimit të realizuar, por jo më shumë se deri në dy paga mujore në vit. Ky shpërblim jepet në mbylljen e rezultatit vjetor dhe caktohet nga organi që ka në kompetencë emërimin e tyre.

6. Punonjësit e ndërmarrjeve, që funksionojnë sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", përfitojnë shpërblim suplementar jo më shumë se dy paga mujore në vit për secilin prej tyre.

7. Punonjësit e ndërmarrjeve, që funksionojnë sipas ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", përfitojnë shpërblim suplementar jo më shumë se 15 për qind të fitimit të realizuar, vetëm kur ndërmarrjet e kanë rezervën përkatëse, por jo më shumë se dy paga mujore në vit për secilin prej tyre.

8. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për efekt page, barazohet me ministrin e Financave. Drejtorët e përgjithshëm të bankave të nivelit të dytë, drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, drejtori i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore barazohen, për efekt

page, me klasifikimin A9, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

Punonjësit e këtyre institucioneve përfitojnë shpërblim suplementar jo më shumë se dy paga mujore në vit për secilin punonjës, në varësi të rezultatit financiar të institucionit.

9. Për ndërmarrjet, veprimtaria e të cilave është me humbje dhe subvencionohen nga shtetit (jo për diferencën e çmimeve), ministritë shqyrtojnë programin financiar të tyre dhe caktojnë fondin e pagave për periudhën përkatëse.

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992 “Për shpërblimin e punës së punonjësve” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko